

S H E N I M E T S H P J E G U E S E

Sqarim:

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2 i permiresuar

Plotesimi i te dhenave të kësaj pjese duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarde te percaktuara ne SKK 2 te permiresuar. Rradha e dhenies se spjegimeve duhet te jetë :

- a) Informacion i përgjithshëm dhe politikat kontabël
- b) Shënimet qe shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare
- c) Shënime të tjera shpjeguese

A I Informacion i përgjithshëm

- 1 Kuadri ligjor: Ligjit 9228 dt 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
- 2 Kuadri kontabel i aplikuar : Stndartet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi.(SKK 2)
- 3 Baza e perqatitjes se PF : Te drejtat dhe detyrimet e konstatuara.(SSK 1)
- 4 Parimet dhe karakteristikat cilesore te perdonura per hartimin e P.F. : (SKK 1)
 - a) NJESIA EKONOMIKE RAPORTUSE ka mbajtur ne llogarite e saj aktivet,pasivet dhe transaksionet ekonomike te veta.
 - b) VIJIMESIA e veprimtarise ekonomike te njesise sone raportuse eshte e siguruar duke mos pasur ne plan ose nevoje nderprerjen e aktivitetit te saj.
 - c) KOMPENSIM midis nje aktivi dhe nje pasivi nuk ka , ndersa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetem ne rastet qe lejohen nga SKK.
 - d) KUPTUSHMERIA e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e plete per te qene te qarta dhe te kuptushme per perdonues te jashtem qe kane njohuri te perqjitheshme te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.
 - e) MATERIALITETI eshte vleresuar nga ana jone dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane hartuar vetem per zera materiale.
 - f) BESUSHMERIA per hartimin e Pasqyrave Financiare eshte e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e meposhteme :
 - Parimin e paraqitjes me besnikeri
 - Parimin e perparese se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore
 - Parimin e paaneshmerise pa asnjë influencim te qellimshem
 - Parimin e maturise pa optimizem te teperuar,pa nen e mbivleresim te qellimshem
 - Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te PF.
 - Parimin e qendrushmerise per te mos ndryshuar politikat e metodat kontabel
 - Parimin e krahasushmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

A II Politikat kontabël

Per percaktimin e kostos se inventareve eshte zgjedhur metoda "FIFO" (hyrje e pare , dalje e pare.(SKK 4)

Vleresimi fillestari i nje elementi te AAM qe ploteson kriteret per njojje si aktiv ne bilanc eshte vleresuar me kosto. (SKK 5; 11)

Per prodhimin ose krijimin e AAM kur kjo financohet nga nje hua,kostot e huamarrjes (dhe interesat) eshte metoda e kapitalizimit ne koston e aktivit per periudhen e investimit.(SKK 5)

Per vleresimi i mepaseshem i AAM eshte zgjedhur modeli i kostos duke i paraqitur ne bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar. (SKK 5)

Per llogaritjen e amortizimit te AAM (SKK 5) njesia jone ekonomike ka percaktuar si metode te amortizimit te ndertesave metoden lineare dhe per AAM te tjera metoden e amortizimit mbi bazen e vlefteve se mbetur ndersa normat e amortizimit jane perdonur te njellojta me ato te sistemit fiskal ne fuqi dhe konkretisht :

- Per ndertesat me 5 % te vlefteve se mbetur
- Kompjutera e sisteme informacioni me 25 % te vlefteve se mbetur
- Te gjitha AAM te tjera me 20 % te vlefteve se mbetur

Per llogaritjen e amortizimit te AAJM (SKK 5) njesia ekonomike raportuese ka percaktuar si metode te amortizimit metoden lineare me normen e amortizimit me 15 % ne vit.



SHENIME SHPJEGUESE; Per periudhen 01 Janar deri me 31 Dhjetor 2018.

Ne kete aneks paraqiten informacionet shpjeguese ne lidhje me perqatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare te njesise ekonomike INTELLIGENT SYSTEMS ALBANIA sh.p.k.

Njesia ekonomike INTELLIGENT SYSTEMS ALBANIA sh.p.k e krijuar me date 14.05.2010, ushtron aktivitetin e saj ne kryerjen e sherbimeve te konsulences ne fushen e teknologjise se informacionit (IT) ne qytetin e Tiranes, me adresë Njesia Bashkiake Nr.5, Rr "Andon Zako Cajupi" Zayed Bussines Center, Kati 7.

Per periudhen 01 Janar 2018 deri me 31 Dhjetor 2018 jane perqatitur dhe paraqitur paketa e plete e pasqyrave financiare, te cilat jepin pamjen te vertete dhe te drejte te pozicionit financiare, performances financiare dhe fluksit te parase gjate kesaj periudhe.

Pergatitja dhe paraqitja e tyre, e cila eshte perqyjet e Drejtimit te subjektit, eshte realizuar mbeshtetur ne Ligjin nr 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit(KKK). Gjuha e perdonur eshte gjuha shqipe. Monedha e perdonur eshte monedha Leke. Rrumbullakime te vlerave nuk ka. Ngjarjet dhe trasaksionet jane evidentuar gjate gjithe periudhes ushtrimore ne perputhje me SKK nr 1 Kuadri i pergjithshem per perqatitjen e pasqyrave financiare dhe SKK nr 2 Paraqitura e pasqyrave financiare si dhe cdo standard tjeter kombetar ne perputhje me natyren e ngjarjeve apo transaksioneve te cilat ne menyre te hollesishme do te jepen ne vijim te informacioneve shpjeguese.

❖ Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren BILANC.

Paraqitura e kesaj pasqyre eshte mbeshtur ne paketen e plete te standardeve te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit. Ne vijim do te jepen informacionet shpjeguese per zerat perberes te saj.

I. Informacione Shpjeguese per AKTIVET.

Totali i aktiveve te paraqitura ne pasqyren e Bilancit jane ne vleren **11,714,839 leke** detajimi nepermjet informacioneve shpjeguese i te ciles paraqitet si vijon;

✚ Informacione shpjeguese te AKTIVE AFATSHKURTRA

Aktiveve afatshkurtra jane paraqitur ne vleren **9,707,911 leke** te cilat jane te perbera nga;

1. Aktive monetare 783,093 leke. Ky ze eshte paraqitur ne pasqyre duke u mbeshtetur edhe ne SKK nr 12 *Efektet e ndryshimeve te kurseve te kembimit* dhe paraqet tepricen e llogarise Arka dhe tepricen e llogarise banke, ne monedhen lek dhe euro ne date 31.12.2018. Kursi i kembimit eshte perdonur ne menyre sistematike gjate gjithe ushtrimit te aktivitetit te subjektit per ngjarjet e transaksionet te cilat jane kryer ne monedha te huaja.

2. Te drejta te arketueshme te cilat jane paraqitur ne vleren **8,924,818 leke** dhe eshte e perbere nga;



Zeri, Nga aktiviteti i shfrytëzimit ne vleren **7,759,212 leke**, i cili eshte evidentuar edhe ne perputhje me SKK nr 3 ne te cilen përfshihen të gjitha të drejtat e krijuara gjate periudhes ushtrimore ndaj klientave për shitjen e mallrave, produkteve dhe shërbimeve me arkëtim të mëvonshëm, te paraqitura me vleren neto te realizueshme.

Zeri, Të tjera ne vleren **948 ,925 leke**, përfshin huadhenie afatshkurtra te njesise ekonomike te cilat do te arketohen ne te ardhmen si dhe garancia per qerane.

Zeri, Kerkesa ndaj tatim taksave ne vleren **216,681 leke**, pëfshihen të gjitha të drejtat e njësisë ndaj të tretëve, te krijuar gjate periudhes ushtrimore, dhe detajimi i saj paraqitet si vijon;

Emertimi	Ref.	Vlera
Tatim fitimi	444	216,681
Totali		216,681 leke

3.Inventari i paraqitur ne vleren **0 leke**, i cili eshte i perbere vetem prej;

Zeri *Mallra* ne vleren **0 leke** jane njohur dhe vleresuar ne perputhje me SKK nr 4 *Inventaret*. Kostoja e inventarit eshte vleresuar me metoden e kostos mesatare te ponderuar.

Mallrat e blera gjate periudhes ushtrimore jane **0 leke** dhe kosto e mallrave te shitur e cila eshte pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte **0 leke**.

4.Shpenzime te shtyra ne vleren **0 leke** perfshijne interesat e huase qe u njohen si shpenzime gjate vtitit ushtrimor.

♦ Informacione shpjeguese te AKTIVET AFATGJATA

Aktivet afatgjata jane paraqitur ne Vleren Kontabel Neto **2,006,927 leke**. Ato jane evidentuar edhe ne perputhje me SKK nr 5 Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale. Paraqitia e tyre eshte bere nepermjet politikes kontabel Metoda e Kostos. Perberja e ketij zeri paraqitet si vijon;

1.Aktive afatgjata materiale jane ne vleren **2,006,927 leke** dhe eshte i perbere vetem nga zeri *Pajisje kompjuterike, pajisje zyre* ne vleren **2,006,927 leke**. Metoda e perzgjedhur per amortizimin eshte metoda mbi vleren e mbetur per aktivet e tjera, dhe eshte njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve per periudhen ushtrimore ne vleren **565,575 leke**. Ne te jane te perfshire elementet e meposhtem;

Nr. Llogarie	Emertimi i Llogarise	Monedha	Debi	Kredi
2181	Mobilje dhe pajisje zyre	LEK	1,071,534	
2182	Pajisje informative	LEK	1,781,350	
2188	Të tjera	LEK	739,945	
28181	Per mobilje dhe pajisje zyre	LEK		379,076
28182	Per Pajisje Informative	LEK		1,015,233
28183	Per te tjera	LEK		191,593
<i>Totali:</i>			3,592,829	1,585,902
<i>Diferencia:</i>			2,006,927	

Faqe 2 nga 5



II. Informacione Shpjeguese per DETYRIMET.

Detyrimet e paraqitura ne pasqyren e Bilancit jane ne vleren **20,862,203 leke** dhe perbehet vetem nga detyrime te periudhave afashkurtra. Detajimi jepet nepermjet informacioneve shpjeguese si vijon;

✳️ Informacione shpjeguese te DETYRIMEVE AFATSHKURTRA

Detyrimet afatshkurtra jane paraqitur ne total ne vleren **20,862,203 leke**, dhe jane te perbera nga detyrimet ndaj furnitoreve, punonjesve , detyrime ndaj shtetit per tatime dhe taksa dhe huamarrje afatshkurter.

- Titujt e huamarrjes ne vleren **12,383,700 leke** perbejne huamarrje afatshkurter nga Intelligent Systems Bulgaria.
- Arkëtime në avancë për porosi ne vleren **0 leke** perbejne arketimet ne avance nga klientet per shitje qe do te kryhen ne periudhen e ardhshme ushtrimore.
- Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit ne vleren **5,228,608 leke** perbejne detyrimin per mallra dhe sherbime te blera e te papaguara deri ne fund te vitit 2018.
- Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore ne vleren **1,708,439 leke** perbejne vetem detyrimin per sigurimet shoqerore dhe shëndetsore te muajit Dhjetor 2018 dhe detajohet si vijon;

Elementi	Ref	Vlera
Pagat e personelit	421	1,311,745
Sigurime shoqerore dhe shëndetsore	431	396,694

- Të pagueshme për detyrimet tatimore ne vleren **1,541,456 leke** perbejne detyrimin per muajin Dhjetor 2018 dhe detajohet si vijon;

Elementi	Ref	Vlera
Shteti- TVSh për tu paguar	4453	661,785
TAP	447	177,159
Tatim burim	447	702,512

✳️ Informacione shpjeguese te DETYRIMEVE AFATGJATA

Detyrimet afatgjata jane paraqitur ne total ne vleren **0 leke**.

III. Informacione Shpjeguese per KAPITALIN

Kapitali i paraqitur ne vleren **(9,147,365) leke** dhe eshte i perbere nga zerat Kapital i nenshkruar, Rezerva ligjore, Fitime te pasperndara dhe Fitim / Humbje e vitit, detajimi i te cilave do te jepet ne informacionet shpjeguese.



1. Informacione shpjeguese te zerit KAPITAL

Ne kete ze jane paraqitur kapitali i kontribuar nga aksionerët ose nga ortakët dhe jane përbledhur tepricat kreditore të llogarive vijuese:

Emertimi	Ref	Vlera
Kapitali i paguar,	101	2,000,000
Totali		2,000,000 leke

Ne perputhje me aktin e themelimit date 14.05.2010 kapitali i nenshkuar eshte i perbere nga Kuota ose aksione, gjithsej 100 pjese me vlere nominale 20,000 leke secila.

2. Informacione shpjeguese te zerit REZERVA LIGJORE

Zeri i mesiperm perbehet nga rezervat e krijuara nga fitimi i viteve ushtrimore respektive dhe eshte ne vleren **51,120 leke**.

3. Informacione shpjeguese te zerit FITIME TE PASHPERNDARA

Zeri Fitime te pashperndara paraqitet ne vleren (**4,461,491**) leke dhe perfshin fitimet / humbjet që njësia ekonomike ka akumular nga periudhat paraardhëse.

4. Informacione shpjeguese te zerit FITIME TE VITIT

Zeri Fitime te vitit paraqitet ne vleren (**6,736,994**) leke dhe paraqitet rezultati i periudhës rrjedhese ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve pasi eshte zbritur tatimi mbi fitimin.

- ❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE.**

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve eshte paraqitur bazuar ne klasifikimin e shpenzimeve sipas natyres. Ne kete periudhe ushtrimore ka rezultuar nje humbje ne vleren (**6,736,994**) leke.

Zeri Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit te paraqitura ne pasqyre evidenton te gjitha shitjet e realizuara me vleren e tyre neto **28,465,093 leke.**

Zeri Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme te paraqitura ne vleren **0 leke** perfaqesojne koston e mallrave te blera per qellime rishitje. Politika kontabel eshte paraqitur me larte ne zerin *Mallra per shitje* (Inventar).

Zeri Shpenzime të personelit i cili eshte i paraqitur ne vleren **18,869,857 leke** perfaqeson:

1. Shuma *Paga dhe shpërblime* gjate periudhes ushtrimore 01.01-31.12.2018 ne vleren **16,536,657 leke**.
2. Shuma *Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore* (*paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet*) gjate periudhes ushtrimore 01.01-31.12.2018 ne vleren **2,333,200 leke**.

Nga keto vlera vetem shuma **1,311,745 leke** eshte ende e papaguar e cila eshte pasqyruar ne bilanc, dhe per te cilen jane dhene informacione shpjeguese me larte.

Zeri Shpenzime të tjera shfrytëzimi te cilat jane te paraqitura ne vleren **15,419,086 leke** perfaqesojne shpenzimet te cilat jane kryer per zhvillimin e aktivitetit te njesise ekonomike, dhe perfaqeson zera te shpenzimeve si furnitura, taksa te ndryshme etj.

Zeri Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitet ekonomike brenda grupit) te cilat jane te paraqitura ne vleren **365,782 leke**, perfaqesojne te ardhurat qe vijnë nga interesa bankare si dhe te ardhura nga diferenca pozitive te kurseve te kembimit.

Zeri Shpenzime interesit dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitet ekonomike brenda grupit) te cilat jane te paraqitura ne vleren **(713,351) leke**, perfaqesojne shpenzimet e interesit sipas kontrates me I.S.Bulgaria.

❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren CASH FLOW.**

Ne pasqyren e flukseve monetare jane paraqitur flukset hyrese dhe dalese te mjeteve monetare në njësine ekonomike gjatë periudhës korrente kontabël. Paraqitia eshte bere sipas metodes indirekte.

Gjate periudhes kontabel ka rezultuar;

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit ne vleren **(216,076) leke**. Fluksi negativ ka ardhur pasi flukset dalese te mjeteve monetare per kryerjen e shpenzimeve si psh, paga, detyrime per kontribute te sigurimeve dhe te tatim-taksave jane me te larta se flukset hyrese te mjeteve monetare gjate ushtrimit normal te aktivitetit nga njesia ekonomike.

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit ne vleren **0 leke**.

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit ne vleren **0 leke**.


❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren NDRYSHIMEVE TE KAPITALIT .**

Ndryshimet ne zelin Kapital kane ardhur si rezultat;

1. Fitim / Humbje e vitit ne vleren (6,736,994) leke.

Informacionet shpjeguese per zerat e mesiperme jane dhene ne pasqyren e Bilancit.

Drejtuesi


Kristina Forbs

Faqe 5 nga 5